

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshit, Mëshirëplotit

Të nderuar lexues,

Është i pamohueshëm fakti se një nga traditat më të përhapura në botë, sigurisht edhe në vendin tonë, është konsumimi i alkoolit. Ai përdoret nga breza të ndryshëm dhe shtresa të ndryshme të shoqërisë intelektualë, gra, fëmijë, të pasur, të varfër etj, në jetën private dhe publike, në urime, në lindje e vdekje, në gëzime e hidhërim, në marrëdhëniet e përditshme afariste etj, shkurt në çdo hap të jetës.

Duke parë dëmet e alkoolit, sot në botë është formuar Organizata Botërore Kundër Përdorimit e Pakësimit të Alkoolit. Janë formuar gjithashtu shoqata e institucione të ndryshme shëndetësore për luftën kundër alkoolit. Nga shoqata e institucione të tilla organizohen biseda e seminare, shfaqen filma dokumentarë, shkruhen artikuj të ndryshëm etj, që bëjnë thirrje për t'u larguar nga ky ves i shëmtuar. Janë hapur klinika të veçanta, janë prodhuar vazhdimisht barëra të ndryshme e janë marrë shumë masa të tjera për zhdjekjen e këtij vesi ose për pakësimin e përdorimit të alkoolit, por fatkeqësisht pa përfundim të dukshëm. Shumë alkoolistë kanë përdorur dhe përdorin barëra (p.sh. antabusin etj) për t'iu shmangur alkoolit, por përsëri shumë prej tyre e gjejnë veten të nënshtruar ndaj tij

T'i hedhim një vështrim Kuranit dhe thëniet e të Dërguarit të Allahut Muhamedit s.a.v.s. në lidhje me alkoolin. Në një nga ajetet e Kuranit të Shenjtë thuhet:

“O ju besimtarë, nuk ka dyshim se alkooli, bixhozi, idhujt dhe falli me shigjeta janë të shëmtuara dhe vepra të djallit, prandaj largohuni prej tyre, që të shpëtoni. Nëpërmjet alkoolit dhe bixhozit, djalli nuk dëshiron gjë tjetër, përveç që t'ju çojë në armiqësi dhe urrejtje ndaj njëri-tjetrit, t'ju largojë nga përmendja e Allahut dhe nga namazi; atëherë a po i jepni fund? (Kur'ani 5 : 90,91)

Ka njerëz që mendojnë se me këto ndalime, Islami ia kufizon njeriut lirinë duke i konsideruar udhëresat e tij si pa drejta dhe jo njerëzore. Vërtet, nëse e shikojmë problemin cekët këto ndalime duken si kufizim lirije por nëse i analizojmë hollësisht dëmet që sjell alkooli për njeriun dhe shoqërinë njeriun do të arinim në përfundim se islami me të drejtë e luftonë si një sëmundje kanceroze, të individit dhe të

shoqërisë. Ai që i njeh sa do pakë burimet dhe mësimet e islamit, e di mirë se ai ndalon gjithëçka, që është e dëmshme për organizmin e njeriut. Ai thotë: “ Prandaj, largohuni prej tyre, që të shpëtoni “ :të shpëtoni prej dëmeve fetare morale, shoqërore, shëndetsore etj.

Në Kuranin e shenjtë alkooli përmendet me termin “hamër “. Në këtë term përfshihen të gjitha ato pije që shkaktojnë dehje, që tronditin dhe mpijnë mendjen dhe intelektin e njeriut, pavarësisht nga emertimi i pijës a burimi nga prodhohet. I Dërguari i Allahut Muhamedi s.a.v.s ka thënë “ ***Ajo pije që të deh, kur përdoret në sasi të madhe, është e ndaluar, edhe në qoftë se përdoret në sasi të vogël.***” I Dërguari i Allahut i ka shpjeguar, sqaruar e shkoqitur mësimet e islamit, sipas urdhrave të Allahut, prandaj askush nuk ka të drejtë dhe arsye të thotë se “egzistojnë edhe pije alkoolike që muslimani mund t'i pin”. Shumë mjek të njohur bashkëkohor i kanë bërë të pa themelta pohimet e disa njerëzve të pa udhëzuar (nëse do të mjaftonte t'i quajm vetëm të till) ndër ta edhe mjekët që reklamojnë dhe rekomandojnë dobijtë shëndetsore të alkoolit. Disa prej pohimeve të tyre janë : “Ndihmon tretjen e ushqimit, ngroh organizmin, zgjeron enë e gjakut, largon brengat dhe vuajtje e jetës etj”. Këto janë ndikime të përcipta organike të cilat nuk i vërtetson shkenca e sotme mjeksore. Për këtë kujtojm, lexues të nderuar thëniet e Muhamedit s.a.v.s :

“Alkooli nuk është ilaç, por sëmundje .”

“Allahu nuk ka zbritur sëmundje, pa zbritur edhe ilaçin e saj: prandaj mjekohuni ,por jo me atë që është e ndaluar .”
“Zoti nuk e ka bërë ilaç atë që është e ndaluar(haram).”

Ka edhe intelektualë, të cilët e quajnë prapambetje ndalimn e alkoolit, duke mëtuar (pretenduar) se përdorimi bashkëkohor (!) dhe anasjelltas, lënia e tij na qenka shenjë prapambeturie (!). Edhe më parë, ka pasur ”intelektual”, që e kanë konsideruar alkoolin si ilaç, një mendim, që çuditërisht i ngjan kësaj të “intelektualve të përparuar” të sotëm. Por, këtë pohim e hedhin poshtë sëmundjet e rënda që shkaktohen prej alkoolit, sidomos prej pijeve alkoolike me ngjyrë. Para 170 vjetësh mjeku i famshëm anglez, Thomas Trotter ka thënë : “Alkooli është sëmundje “. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë vërtetësohet se alkoolizmi kronik zë vendin e katërt në listën e sëmundjeve bashkëkohore. Sot shkencëtarët amerikanë kanë vërtetuar se qelizat e organizmit të njeriut nuk janë të përgatitura për duhan dhe alkool, nuk u rezistojnë dot atyre.

Do të donim të përmendnim disa nga dëmet që sjell alkooli:

1. Duke depërtuar në organizëm nëpërmjet gojës, alkooli dëmton buzët, gjuhën dhe fytyrën dhe shkakton mahisjen djegëse, mahisja zhvillohet më tej, në kapërcell dhe shkakton vjellje të ushqimit.

2. Duke ngacmuar mukozën e stomakut, alkooli zgjeron enët e gjakut dhe pas mahisjes vjen ulçera e stomakut i cili është shumë i përhapur ndër alkoolistët.
3. Dëmin më të madh e pëson organi jetësor i organizmit, laboratorit qendror i tij, mëlçia e zezë .
4. Sëmundjet e zemrës dhe të enëve të gjakut shfaqen kryesisht te njerëzit, që e përdorin alkoolin për një kohë të gjatë. Çelësi i mjekimit të sëmundjeve të tilla është ndërprerja e plotë e të gjitha pijeve alkoolike.
5. Alkooli është shkaktar i sëmundjes së tuberkulozit, sepse me përdorimin e tij zvogëlohet forca mbrojtëse e organizmit dhe kështu, egziston mundësia që mikrobi të gjejë truall për t'u zhvilluar.
6. Disa mjekë akuzojnë si kancerogjene, veçanërisht pijet alkoolike me ngjyrë. Statistikat botërore tregojnë se kanceri i feringut, i kapërcellit dhe stomakut është më i shpeshtë tek alkoolistët.
7. Alkooli është shkaktar për ndryshimet në lëkurë, të cilat rrjedhin si pasojë e ndryshimit të enëve të gjakut. Ato i japin një pamje karakteristike fytyrës së alkoolistit hundë të gjerë të kaltër, të cilën e dallon lehtë çdokush.
8. Dëmtohen së tepërmi edhe qelizat nervore, si sistemi nervor qendror, ashtu edhe ai periferik. Pra, me një fjalë të vetmen mund të themi të dashur lexues : nuk ka organ dhe qelizë në organizmin e njeriut, e që nuk dëmtohet nga alkooli.

Alkoolistët e humbasin lehtë drejtimin e sjelljen në shoqëri: trimërin, nderin, ndërgjegjen, shpirti i sakrificës etj ; luhatje seriozisht tek ata. Familja e alkoolistit i ngjan skenës së një teatri, ku shfaqen vetëm komedi dhe tragi-komedi.

Pë dëmet nga alkooli mund të lexojm edhe poezinë e mëposhtme :

*Po, unë jam fodull dhe sokol
Unë quhem alkool!
Në mua është kapaciteti,
Unë jamë trim nate, çdo gjë treti.
Dhe gjatë ditës çudi bëj
Mashkull, femër tok i rrëzoj.
Gjithfarë dhembjesh botës i dhuroj,
Plak e të ri unë shkatërroj.
Të pasurit ia rrëmbej thesarin,
Ja rrëmbej loçkën, ia rrëmbej arin.
Së pari ia marr të parët, shëndetin
Së dyt përsëri trupin, dertin.
Përvetësime kolosale bëj*

Po aq në gjumë i vej
Unë jamë fodull dhe sokol,
Unë quhem alkool!

Kush shijon “ëmbëlsinë” time,
Doemos has në mjerime,
Pak dehje njëherë
I imi do të jesh përherë !
Babai kundër djalit ka frikë,
Nëna, halla i vë në thikë,
Kjo është sipas dëshirës sime,
Thumboj e ther me ngacimime.
Unë jamë fodull dhe sokol
Unë quhem alkool!

Unë mbys kalamaj dhe sabi,
Unë s'njoh mahi,
Unë gruan, burrin e ndaj,
Fuqinë time e mbaj
Unë të gjitha burgjet i hapi,
Në to fus dhe i kapi
Babain, nënën, nusen, hallën.
Djalin, motrën tërë mëhallën.
Dhe çmendinat gjithkund i mbush,
Tmerrësisht I dënoj.
Unë jamë fodull dhe sokol,
Unë quhem alkool !

Shih të riun në rini,
Atë zhurmëtarin si në pleqëri.
Dhe ata të shëmtuar që u bënë,
Këto meritat e mia janë.
Mjerime, pikëllime u bënë!
Unë jam fodull dhe sokol
Una quhem alkool !

Unë jam dhunues në këtë botë,
Çdo njeri e fus në një gotë,
Kur ka në çdo anë,
Dhe të fuqishmin e fus n'bela
Unë nuk njoh kurrfarë kariere
Dhe ligji më përkulet me respekt,
Dhe ligjet më nënshtrohen mua
Sepse gjëmat e mia s'numërohen.
Unë jam fodull dhe sokol
Unë quhem alkool !

Kush me mua shoqërohet,

Për të, ditë e zezë agon,
Për tërë jetën fatin ia rrëmbej
Të vdekurit sa me qiri s'i shërbej.
Unë jam fodull dhe sokol
Unë quhem alkool !

Kush më ngrit me dorë,
Në njëqind gjuma bëhet rezil,
Të gjithë birrashitësve, tregtarëve të verës,
Pastaj xhandarët do ti bien derës,
Që ta rrahin, që ta lidhin,
Në burg ta hedhin.
Andaj çdokush më nënshtohet
Unë jam fodull dhe sokol
Unë quhem alkool !

Lexues i nderuar, besojmë se kjo poezi është këshillë dhe porosi e vlefshme për të përkujtuar dëmet që sjell alkooli si në jetën individuale-private, ashtu edhe në aspektin shoqëror. O ju, që keni vendosur ta braktisni alkoolin, kujtoni ajetet e Kuranit dhe thëniet e të Dërguarit të Allahut ! Kujtoni dëmet që shkakton alkooli ! Ata që me të vërtetë, arrijnë ta braktisin këtë ves të shëmtuar, e kanë fituar betejën me vetvetn dhe kanë arritur begatinë morale dhe shpirtërore, por mbi të gjitha do të arrijnë kënaqësia e Allahut të Madhëruar . Nga Allahu i Gjithëditur vjen mesazhi :“**Ne në Kuran e kemi shpallur atë që është shërim(ilaç) dhe mëshir për besimtarët. (Kur’ani 17:82).** Të nderuar lexues, pasi ta lexoni këtë fletëpalosje tua jepni edhe të tjerëve që të mund të përfitojnë edhe ata prej saj ! Ju përsëndesim vëllazërisht: Paqja, mëshira dhe mirësitë e Allahut qofshin për ju !

SH.Q. “**Klubi Studentor**”
Rr. Stiv Naumov 7/18 1000 Shkup
Tel: ++389 (0)2 22 36 54
e-mail: klubistudentor@hotmail.com

Alkooli

